



KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI

Kuvendi Komunal-Junik

Nr. 01-02/24

Datë: 28. 03. 2024, ora 15⁰⁰

PROCESVERBAL

Mbledhja e Dytë e Rregullt e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, mbajtur më datën 28 Mars, 2024, në orën 15⁰⁰, në lokalet e Kuvendit Komunal në Junik.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin anëtarët e këtij Këshilli si në vijim:

1. Ruzhdi Shehu-kryetar i Komunës-Kryesues i KKS-së,
2. Rasim Syla-komandant i Stacionit Policor në Junik,
3. Xhavit Velijaj-drejtor i Drejtorisë për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport,
4. Zejnepe Gaxherri-kryesuese e Komitetit për Komunitete,
5. Xhavit Gaxherri-kryetar i Këshillit të Prindërve të Arsimit të Komunës së Junikut,
6. Shkëlzen Shehu-përfaqësues i Emergjencave Civile Komunale,
7. Qamil Jasiqi-përfaqësues nga Komuniteti i Personave me Aftësi të Kufizuara,
8. Afërdita Shehu-kryesuese e Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi,
9. Imer Krasniqi-përfaqësues i Bashkësisë Islame,
10. Leonita Jasiqi-përfaqësuese e Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim,
11. Ariola Krasniqi- zyrtare për Barazi Gjinore, dhe
12. Driton Syla-“Teqja e Madhe Amë e Tarikatit Alijjei- Haletije Xhaferi”, Junik,

Në këtë mbledhje munguan; Albestrim Rexhepi-përfaqësues i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Arsim Shehu-përfaqësues nga Komuniteti i Biznesit, Dukagjin Lolluni-përfaqësues nga OJQ, dhe Arbër Gjota-përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe nënkryetari i Komunës-koordinator i KKS-së z. Besart Tofaj dhe rreshteri i policisë në Junik z. Dinë Tofaj.

Mbledhjen e Dytë të Rregullt të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2024 e shpalli të hapur koordinatori i KKS-së z. Besart Tofaj, i cili përshëndeti pjesëmarrësit në këtë takim, dhe nga anëtarët e Këshillit kërkoj miratimin e Rendit të Ditës si më poshtë:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Gjendja e sigurisë në Komunën e Junikut,
3. Mirëmbajtja e shkollave, siguria përreth objekteve shkollore dhe shëndeti tek nxënësit e Komunës së Junikut,
4. Diskutim mbi aktivitetet për pengimin e krijimit të deponive ilegale, mirëmbajtjes së lumenjëve dhe hapësirave publike, dhe
5. Të ndryshme.

Rendi i Ditës u miratua me dymbëdhjetë vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim.

Pika e Parë të Rendit të Ditës **Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar**

Koordinatori z. Besart Tofaj kërkoj shqyrtimin e procesverbalit të kaluar, i cili me dymbëdhjetë vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim u miratua nga anëtarët e KKSB-së.

Pika e Dytë e Rendit të Ditës **Gjendja e sigurisë në Komunën e Junikut**

Fjalën e mori komandanti i Policisë në Junik z. Rasim Syla, i cila tha, gjendja e sigurisë në Komunën e Junikut në përgjithësi është e qetë. Që nga takimi i fundit apo në tremujorin e fundit nuk kemi pasë ndonjë rast që ka mundur ta prish imazhin e policisë apo të sigurisë. Kemi pasë vetëm tri raste për këta tre muaj të cilat nuk e kanë dëmtuar çështjen e sigurisë në Komunën e Junikut.

Sa u përket vjedhjeve dhe grabitjeve nuk bëhet fjalë në Junik. Kemi plane operative për mbrojtjen e florës dhe faunës, që përfshinë ndërtimet pa leje, degradimet, vrasjet e kafshëve të egra, zjarrvëniet në këtë sezonë, dhe të tjera që lidhen me Parkun Nacional. Kemi edhe pikën statike të Laura e Jasiqit, ku policët me punë sekondare që është në marrëveshje me Ministrinë e Mjedisit, kanë detyra shtesë sa u përket lëvizjeve në zonën e Parkut Nacional.

Sa i përket rregullimit të trafikut kemi shqiptuar diku rreth 200 gjoba. Javën e kaluar kemi bërë edhe një plan veprimi për përdorimin e telefonit gjatë vozitjes së shoferëve, për çka kemi shqiptuar disa gjoba, ndërsa në këta tre muaj nuk kemi pasë asnjë aksident të trafikut në Komunën e Junikut, dhe kjo si shkak se në brenda 24 orëve mbajmë së paku 5-6 pika të kontrollit.

Sa i përket sigurisë në shkolla gjatë këtij muaji unë kam qenë disa herë të shkollat rreth orës 7:00 të mëngjesit, në mënyrë që të shoh se si policia po e trajton çështje e sigurisë së trafikut te shkollat, dhe mund të them se siguria te shkollat është mjaftë e lartë.

Z. Besart Tofaj pyeti se cili ka qenë shkak i shqiptimit të këtyre gjobave në trafikut në këtë periudhë?

Z. Rasim Syla tha, ka pasë kundërvajtje të ndryshme por shumica e tyre kanë qenë për tejkalim të shpejtësisë.

Z. Besart Tofaj pyeti për rolin dhe ndikimin në trafik të veturës inteligjente në Komunën e Junikut.

Z. Rasim Syla tha, kjo është hera e tretë apo e katërt që kjo veturë vjen këtu nga trafiku rajonal, por neve nuk na ka dhënë ndonjë indikacion se në Junik mund të jetë ndonjë dukuri që nuk e kemi kryer sa u përket kundërvajtjeve në trafik.

Z. Xhavit Gaxherri, pyeti nëse ka pasë ndonjë gjobë për kundërvajtje lidhur me zjarrvëniet te varrezat që kanë ndodhë para dy tri javësh?

Z. Rasim Syla tha, sa i përket zjarrvënieve ne çdoherë kemi bashkëpunim dhe gjithmonë intervenojmë së bashku me zjarrfikësit, po ne shpesh bëjmë kallëzime penale, dhe me shënime zyrtare lënda shkon drejtë në prokurori.

Kryetari z. Ruzhdi Shehu ceku se ka shtim të zjarrvënieve dhe përdorim të substancave narkotike sipas referimit të vlerësimit të gjendjes, ndërsa kërkoj që të shtohen masat e monitorimit, dhe kapacitetet e sigurisë, qoftë te ambienti apo te objektet tjera, te zjarrvëniet, dhe derdhja e mbeturinave jashtë deponive të caktuara legale. Pra, kërkoj vigjilence dhe bashkëpunim të organeve relevante dhe të qytetarëve për luftimin e këtyre dukurive. Ne poashtu kemi shqiptuar dënime për hedhjen ilegale të mbeturinave kohëve të fundit, dhe kjo do të vazhdoj në të ardhmen, dhe kërkoj që këto raste të lajmërohen dhe të zbatohet ligji. Z. Ruzhdi Shehu njoftoj se Komuna e Junikut ka formuar edhe një komision kundër dhunës në familje dhe tha se shumë shpejtë do ta ketë edhe planin e veprimit dhe do të bashkëpunim me qendrën regjionale në Pejë.

Z. Rasim Syla tha, ne bëjmë identifikimin dhe rifreskimin e listës së përdoruesve të narkomanëve në zonën tonë të përgjegjësive, dhe në bazë të analizave ne llogarisim se sa material të narkotikëve hynë në Junik. Është edhe njësitë rajonal që në kemi bashkëpunim dhe dërgojmë informata për personat që ne dyshojmë se mund të jenë narkomanë. Kjo është një dukuri mjaftë shqetësuese e cila mund të bartë edhe probleme të tjera në familje. Jemi duke punuar mirë në këtë drejtim, dhe rezultatet do të shihen më vonë, ndërsa lidhur me mbeturinat duhet të kemi bashkëpunim dhe mobilizim.

Z. Xhavit Gaxherri pyeti se sa është numri i përdoruesve të narkotikëve në Komunën e Junikut.

Z. Rasim Syla tha, unë nuk e di numrin, nuk i kam statistikat këtu.

Z. Imer Krasniqi tha, unë e përgëzoj kryetarin për iniciativën e marrë për pastrimin e rrugëve lokale nëpër Junik, por kërkoj nga inspektorët që të marrin masa të rrepta ndëshkuese lidhur me hedhjen ilegale të mbeturinave.

Z. Imer Krasniqi po ashtu kërkoj nga komandanti i policisë z. Rasim Syla që të marrë masa shtrënguese ndaj tregtarëve të narkotikëve, nëse ka informacion. Ndërsa tha, kjo është shqetësuese dhe luftimi i kësaj dukurie negative është i nevojshëm, sepse këtu është duke qarkulluar droga.

Z. Rasim Syla tha, ne nuk kemi ndonjë informacion që ka furnizues me narkotikë në Junik, dhe nuk kemi objekte argëtuese afër shkollave në Junik.

Rreshteri i policisë z. Dinë Tofaj tha, nëse ka shpërndarës apo përdorues të narkotikëve është mirë që ata të adresohen me emër. Ne si zyrtarë komunal, si polici apo si qytetarë jemi të thirrur që t'i luftojmë këto dukuri. Ne si polici kemi projekte dhe kemi bërë fushata vetëdijësuese në shkolla lidhur me këto dukuri. Në shkolla janë mbajtur ligjëratat dhe janë bërë teste me pyetësorë për identifikimin e dhunës në shkollë apo për diçka të dyshimtë në shkollë, ku vepron edhe këshilli i sigurisë, psikologeja, dhe pedagogeja, e cila është edhe mbikëqyrëse e këtij projekti, dhe do të vlerësohet gjendja e përgjithshme në shkolla.

Ne kemi fushata vetëdijesuese me KLSP-në edhe për sigurinë në bjeshkë. Ne si polici kudo që shkojmë prezantojmë edhe numrat kontaktues të telefonit, ku qytetarët mund të thirrën dhe të lajmërojnë lidhur me këto çështje.

Z. Imer Krasniqi tha, me gjithë respektin që kam për policinë, ata nuk duhet të presin që të marrin informacion, por duhet t'i identifikojë pikat e rrezikut sikurse në komunikacion, dhe të ndërmarrin masa të menjëhershme.

Pika e Tretë e Rendit të Ditës

Mirëmbajtja e shkollave, siguria përreth objekteve shkollë dhe shëndeti tek nxënësit e Komunës së Junikut

Drejtori z. Xhavit Velijaj tha, sipas planit të shkollës mirëmbajtja në përgjithësi është e mirë dhe në nivelin e duhur. Ne jemi duke punuar vazhdimisht që t'i rrisim kapacitete në shkollë, dhe muajin e kaluar kemi angazhuar edhe një punëtor teknik. Kjo ka qenë kërkesë nga drejtorja e shkollës sepse tani objekti i ri i shkollës ka më shumë hapësirë sesa objektet e vjetra të shollës, dhe tani me këtë mbulohet e gjithë hapësira e brendshme dhe e jashtme e shkollës.

Lidhur me sigurinë kemi të vendosura kamerat e sigurisë. Kemi disa shkëputje të rrethojave, dhe jemi në proces të bëjmë edhe disa vend-parkingje, dhe të përmbillet pjesa e rrethojës.

Lidhur me shëndetin e nxënësve kemi në plan që të organizojmë një vizitë mjekësore në muajin Prill, për të gjitha nivelet e nxënësve deri në e klasën e 9-të.

Z. Xhavit Gaxherri pyeti për mjetet teknike për pastrim në shkolla, nëse ato aparatura janë adekuate, e tillë siç është fshesa industriale, ndërsa tha se sistemi xhoker nuk është i një standardi të kënaqshëm. Ndërsa për shëndetin në shkolla tha se do të themelohet grupi i promovimit të shëndetit në shkollë, që do të bëjë analizat për evidentimin e çdo nxënësi, nëse ka ndonjë simptomë apo shqetësim shëndetësor.

Z. Xhavit Gaxherri, lidhur me sigurinë kërkoj që të bëhen rrethojat, të nxjerrën parkingjet dhe të evitohen rreziqet e mundshme të nxënësve, ndërsa tha, mua po më shqetëson mungesa e shkallëve emergjente në shkollë.

Z. Xhavit Velijaj tha, do të bëhet zgjerimi i hapësirës për parkingje dhe do të kryhen rrethojat e shkollës, ndërsa për shkallët emergjente, Ministria ka thënë se do të ketë një projekt për të gjitha shkollat, dhe në kuadër të kësaj do të jetë edhe shkolla jonë.

Z. Imer Krasniqi kërkoj që në nivel të shkollës të organizohet një fushatë vetëdijesuese lidhur me rreziqet e diabetit nga pijet energjike dhe ushqimet jo të shëndetshme që konsumohen nga nxënësit.

Z. Xhavit Gaxherri tha, do kishte qenë mirë që ushqimet e nxënësve të përgatiten në shtëpi nga prindërit e tyre.

Z. Ruzhdi Shehu tha, siguria dhe mirëmbajtja e objekteve të shkollave duhet të trajtohet sepse ka mungesë bashkëpunimi në mes të prindërve dhe mësimitdhënësve. Pra, kjo duhet të nxitet nga drejtorët, Drejtorja e Shkollës dhe Këshilli i Prindërve, sepse kjo paraqet pasiguri dhe rrezik te shëndeti në shkollë. Ndërsa kërkoj që në orët e para të mësimit të mbahen rreth pesë minuta mësim edukativ për nxënësit, ku përfshihen mirësjellja, mbrojtja e ambientit dhe çështje të tjera për sigurinë e tyre. Ndërsa tha, unë kërkoj

që të mbahet edhe një test i diturisë për klasët e 5-ta, dhe çështja tjetër është që të mos lejohet pjesëmarrja e fëmijëve nën moshën legale në institucionet fetare pa pëlqimin e prindërve të tyre.

Z. Qamil Jasiqi kërkoj që nxënësve nga klasët 1-5 çdo javë t'u bëhet kontrolli i dhëmbëve, dhe poashtu pa dijeninë e tyre gjatë pushimeve në mes të orëve t'u kontrollohen çantat e nxënësve të shkollës fillore dhe të mesme, dhe të bëhet monitorimi nëse mbahen orët e edukatës fizike në shkolla.

Z. Xhavit Gaxherri kërkoj që në kuadër të mësimin të hynë një projekt për moral dhe edukatë për klasët 1-5, ashtu siç është modeli i mësimin në Japoni.

Z. Ruzhdi Shehu tha, unë kërkoj nga Këshilli i Prindërve të Shkollave që t'i identifikojnë dukuritë negative të nxënësve në shkolla, në mënyrë që të merren masa dhe të gjenden forma për evitimin e tyre.

Z. Xhavit Velijaj tha, kemi shqetësime për agjërimitin e nxënësve në shkolla, sepse kjo u shkakton probleme në mësim.

Pika e Katërt e Rendit të Ditës

Diskutim mbi aktivitetet për pengimin e krijimit të deponive ilegale, mirëmbajtjes së lumenjëve dhe hapësirave publike

Z. Ruzhdi Shehu lidhur me mbeturinat tha, ne kemi të caktuar deponinë për mbeturinat inerte, që është te firma "Joos Krasniqi", ku bëhet trajtimi i tyre sipas standardeve.

Tjetër, ne kemi dëmtime nga ana e firmave të gurthyesve, ku po bëhet eksploatimi i lumenjve nga ana e tyre, dhe duhet të gjendet një mënyrë bashkëpunimi me regjionin apo me nivelin qendror, që të bëhet parandalimi i këtij fenomeni.

Dhe, e fundit është që ne si institucione duhet të krijojmë motivim, bindje dhe besim, që ne jemi duke punuar, në mënyrë që njerëzit, sidomos rinia të qëndrojnë dhe të punojnë këtu, dhe të mos imigrojnë në tregje dhe shtete tjera. Pra, të gjejmë mënyra të komunikimit dhe bashkëpunimit, në mënyrë që kjo dukuri negative të parandalohet. Lidhur me këtë, takimet fizike me nxënësit, rininë dhe qytetarët janë të domosdoshme, përfundoj z. Shehu.

Pika e Pestë e Rendit të Ditës Të ndryshme

Z. Imer Krasniqi kërkoj që Komuna të ofrojë infrastrukturë apo një objekt, ku mund të mbahen kurse të gastronomisë apo përgatitje të ushqimeve, sepse tani kemi rrugën dhe turizmin në bjeshkë.

Me kaq, koordinatori, z. Besart Tofaj shpalli të mbyllur këtë mbledhje të KKS-së.

Procesmbajtësi,


Gëzim Geci

Kryetari i Komunës, Kryesues i KKS-së


Ruzhdi Shehu